



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO

Ac.nr.9796/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Shala kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Bujar Muzaqi anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit – propozuesit të sigurimit M.M. , nga P. rruga M. K. nr.... të cilin me autorizim e përfaqëson A. L. avokat nga P. , kundër të paditurës – kundërshtarit të sigurimit IQ to L.G.- W. C. , Dega Kosovë rruga U.H. nr..., të cilën me autorizim e përfaqëson F. L. avokat nga P., për kthim në punë dhe kompensim të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.5912/21 i datës 15.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit – propozuesit të sigurimit M.M. , nga P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.5912/21, i datës 15.10.2021 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.5912/21, të datës 15.10.2021, e ka hedhur si të pa afatshme padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit të paditësit

– propozuesit të sigurimit , kundër të paditurës - kundërshtarit të sigurimit IQ to L.G.- W. Company , Dega Kosovë Kolegji e ushtruar me datë ... për kthim në punë dhe kompensim të ardhurave personale.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të : shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që aktvendimi ankimor të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për gjykim meritor.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të neneve 237.1 dhe 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësit , është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi M.M.ri nga P. përmes të autorizuarit të tij A.L. avokat nga P. , me datë..., në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi për kthim në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale me propozim caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsë, kundër të paditurës IQ to L. G.- W. C. , Dega Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit jashtë seancës për shqyrtim kryesor duke u kujdesur për afatin e padisë, padinë e paditësit e ka hedhur si të pa afatshme. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se padia e paditësit është e pa afatshme, kjo ngase paditësi padinë nuk e ka parashtruar brenda afatit ligjor. Nga këtu e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 79, të Ligjit të Punës dhe dispozitën e nenit 391 pika f) të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ndërsa për shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur që secila palë ti barte shpenzimet e veta, në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, po ashtu drejtë është aplikuar e drejta materiale për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftuar për faktin vendimtar rreth afatshmërisë së padisë së paditësit dhe në këtë drejtim aktvendimi i ankimuar nuk është kundërthënës me përmbajtjen e dokumenteve dhe provave të paraqitura ashtu siç theksohet në ankesë.

Siç rrjedh nga shkresat e çështjes paditësi me padinë e paraqitur nga gjykata ka kërkuar mbrojtje gjyqësore, ashtu që mbi bazë të kontratës së punës në kohë të pa caktuar të cilën e ka lidhur me të paditurën të kthehet në punë dhe ti kompensohen të ardhurat personale, pasi që shkëputja e kontratës së punës është e kundërligjshme.

Gjykata e shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vëren se paditësi me të paditurën kanë pasur të lidhur kontratë të punës për periudhë të pa caktuar kohore kontrata është lidhur më datë 14.04.2020.

Po ashtu, nga padia dhe shkresa për shkëputjen e kontratës së punës vërehet se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës më datë 01.10.2020, dhe të njëjtën ditë e ka pranuar shkresën e cekur më lartë me të cilën është njoftuar se i shkëputet kontrata e punës (këtë e ka pohuar vetë i autorizuari i paditësit).

Paditësi para një situatë të tillë, nuk ka kërkuar drejtpërdrejte mbrojtje gjyqësore në kontest pune me padi por i është drejtuar me kërkesë dhe ankesë inspektoratit të punës, por edhe nga dita e marrjes së këtyre vendimeve administrative paditësi prape nuk e ka paraqitur padinë në afatin prej 30 dite.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar faktin se paditësi nuk e ka ushtruar padinë brenda afatit ligjor, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës (LP-së). Paditësi shkresën për shkëputjen e kontratës së punës të paditurës e ka pranuar më datë 01.10.2020, ndërsa padinë në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur më datë 06.08.2021. Por, siç rezulton paditësi padinë nuk e ka paraqitur brenda afatit ligjor ashtu siç e përcakton ligji i punës por padinë e tillë e ka paraqitur pas kalimit të afatit prej 30 ditëve. Padia e paditësit është e pa afatshme pasi që ai nuk e ka paraqitur padinë brenda afatit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës (LP-së).

Me dispozitën e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës është paraparë shprehimisht se çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se ju kanë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 parag.2 i këtij ligji , në afatin vijues prej 30 ditësh mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente. Paditësi nuk i është përmbajtur këtij afati, dhe drejtë gjykat e shkallës së parë e ka zbatuar dispozitën e nenit 391 parag. 1 pika f) të LPK-së duke e hedhur si të pa afatshme padinë e tillë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar të drejtën materiale dhe mbi këtë bazë, pretendimet ankimore të paditësit janë të pa bazuar.

Gjykata e Apelit nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 194, 209 pika b) të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË

Ac.nr.9796/2021, datë 13.12.2021

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,

Burim Shala d.v.